



Kanton Zürich
Bildungsdirektion
Volksschulamt
Pädagogisches, Lehrplan 21

Kontakt: Projekt Lehrplan 21, Projektleitung, Walchestrasse 21, 8090 Zürich
Telefon 043 259 22 99, lehrplan21@vsa.zh.ch

Albanisch

Dëftesa për klasën e 3-të deri në të 6-ën e shkollës fillore (cikli i 2-të)

Informacione mbi prindërit dhe të ngarkuarit për edukim

Mësimdhënia, të mësuarit dhe vlerësimi

Në një mësim të suksesshëm, mësimdhënia, të mësuarit dhe vlerësimi janë ngushtë të lidhura mes vete. Nxënëset dhe nxënësit duhet që vlerësimin ta përjetojnë si një ndihmë në të mësuar dhe si nxitje.

Bazën e mësimit e përbëjnë plani mësimor dhe mjetet mësimore. Duke u nisur nga kjo mësimdhënësit caktojnë qëllimet mësimore. Mësueset dhe mësuesit i nxisin dhe i përkrahin nxënëset dhe nxënësit në krijimin e kompetencave të tyre. Ata ju japin atyre vlerësime mbi rezultatet, mbi zhvillimet mësimore dhe mbi sjelljen. Kështu nxënëset dhe nxënësit njoftohen se ku qëndrojnë dhe çfarë hapash mësimorë do të pasojnë më pastaj. Mësimdhënëset dhe mësimdhënësit provojnë herë pas here se a kanë arritur fëmijët kompetencat përkatësisht qëllimet e caktuara mësimore. .

Si duket dëftesa?

Dy herë në vit personeli mësimor bën dhënien e dëftesave: në fund të janarit dhe në fund të vitit shkollor. Bazë për këtë është vlerësimi i vazhdueshëm në mësim.

Vlerësohen të gjitha lëndët sipas planit mësimor. (Dëftesa e klasës së 3-të të shkollës fillore paraqet një përjashtim. Ajo përfshin vetëm notat në gjermanisht dhe matematikë).

Në dëftesë në gjuhë vlerësohen këto kompetenca: të dëgjuarit, leximi, të folurit dhe të shkruarit. Në klasën e tretë në anglisht vlerësohet vetëm të dëgjuarit dhe të folurit.

Nëse për arsye të veçanta vlerësimi nuk është i mundur, hiqet dorë nga ai. Për rezultatet e shënuara në kurset e bëra vullnetarisht (p.sh. kurset e sportit në shkollë) nuk jepen nota.

Notat nga 6 deri në 1 paraqesin rezultatet e përgjithshme në një nga lëndët. Ato shprehin se në çfarë mase një nxënëse apo një nxënës në pjesën e parë përkatësisht të dytë të vitit ka arritur të zotërojë qëllimet e parashtruara mësimore. Nota në dëftesë bazohet në matjen profesionale të mësimdhënësit. Nota nuk është mesatarja e rezultateve të provimeve me shkrim. Mësimdhënësja apo mësimdhënësi gjatë vlerësimit mbështetet në burime të ndryshme, si për shembull në: provimet me gojë dhe me shkrim, punimet e nxënësve, referatat, soditjet si dhe nga përfundimet që nxirren nga dialogët në mësim dhe bisedat.

Notat në dëftesë definoohen si vijon:

Nota	6	5	4	3	2 dhe 1
	shumë mirë	mirë	mjaftueshëm	pamjaftueshëm	(shumë) dobët
Kriteri	Nxënësja apo nxënësi				
Arritja e qëllimeve mësimore	Arrin qëllimet e vështira mësimore në shumicën e kompetencave me siguri	Arrin qëllimet në të gjitha fushat e kompetencave dhe pjesërisht edhe qëllimet e vështira mësimore	Arrin qëllimet bazë mësimore në pothuajse të gjitha fushat e kompetencave	Nuk i arrin qëllimet bazë mësimore në shumicë prej fushave të kompetencave	Nuk i arrin qëllimet bazë mësimore në shumicën e fushave të kompetencave
Zgjidhja e detyrave	Zgjidh kryesisht me sukses detyrat e vështirësisë së shkallës së lartë	Zgjidh pjesërisht me sukses detyrat e vështirësisë së shkallës së lartë	Zgjidh mjaftueshëm detyrat e nivelit bazë	Zgjidh jo mjaftueshëm detyrat e nivelit bazë	Nuk zgjidh detyrat e nivelit bazë

Ka edhe aspekte që nuk janë pjesë përbërëse e notës së një lënde, si për shembull: zelli i jashtëzakonshëm apo i mangët, bashkëpunimi aktiv në mësim apo jo interesimi, puna me kujdes apo e pasaktë, korrektësia apo jo korrektësia. Këto rezultate shënohen në faqen e dytë të dëftesës në rubrikën qëndrimi ndaj punës dhe të mësuarit si dhe qëndrimi social.



Dëftesat e ndryshme vendosen në një dosje dëftesash. Këto ruhen nga mësuesi përgjegjës i klasës. Në rast të ndërrimit të shkollës apo në fund të ciklit fillor kjo dosje dëftesash i jepet nxënëses apo nxënësit.

Vlerësimi i qëndrimit ndaj punës apo të mësuarit si dhe i qëndrimit social bëhet në katër kategorizime. Vlerësimet në shtyllën e dytë (mirë) i përgjigjen rasteve të rëndomta: www.volksschulamt.zh.ch > Schulbetrieb & Unterricht > Zeugnisse & Absenzen

Formulari i dëftesës

Dëftesat e ndryshme vendosen në një dosje dëftesash. Këto ruhen nga mësuesi përgjegjës i klasës. Në rast të ndërrimit të shkollës apo në fund të ciklit fillor kjo dosje dëftesash i jepet nxënëses apo nxënësit.

Informacione të tjera mbi vlerësimin, mbi dëftesat dhe vendimet mbi ecurinë shkollore gjeni në: www.volksschulamt.zh.ch > Schulbetrieb & Unterricht > Zeugnisse & Absenzen